



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Dokument Parlamentar

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ 2019

RAPORT

PËR PROJEKT-REZOLUTËN

**“PËR MBËSHTETJEN E PROCESIT TË FILLIMIT TË BISEDIMEVE PËR
ANËTARËSIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

Komisioni Parlamentar për Integrimin European në mbledhjet e zhvilluara në datat 01.10.2019 dhe 02.10.2019, ndër të tjera shqyrtoi projekt-rezolutën **“Për mbështetjen e procesit të fillimit të bisedimeve për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”**

Komisioni, bazuar në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi çështjen në përputhje me rendin e dites dhe kalendarin e punimeve të tij. Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare”, të të ligjit nr 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” dhe Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë Kryetarja e Komisionit për Integrimin European Znj. Rudina Hajdari dhe Nënkryetarja e këtij komisioni, Znj. Senida Mesi paraqitën Projekt-rezolutën “Për hapjen e negociatave të Republikës së Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin European”.

Kjo nismë është ndërmarrë në kuadër të vendimit të ardhshëm të Këshillit European për fillimin e bisedimeve për anëtarësim të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veirut në Bashkimin European.

Duke marrë paraqysh rekomandimet e raportit të fundit të Komisionit European, publikuar me datë 29.05.2019 për Shqipërinë, si dhe përparësitë e vendosura në këtë raport për hapjen e negociatave, konsiderohet e rëndësishme që Kuvendi të vijojë me intensitet punën e tij në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Kushtetuta, Rregullorja e tij si dhe ligjet në fuqi përsa i përket në veçanti procesit të integritimit në Bashkimin European.

Përparësitë janë: reforma në drejtësi; administrata publike; lufta kundër korrupsionit; lufta kundër krimit të organizuar si dhe të drejtat e njeriut.

Po ashtu, në një rend demokratik, i cili udhëhiqet nga parime dhe institucione demokratike, vend të veçantë zë edhe reforma zgjedhore.

Duke iu referuar raportit të fundit të OSBE/ODIHR dhe rekomandimeve të tij, reforma zgjedhore merr një rëndësi të posaçme si pararendese e të gjitha reformave të tjera, ku e drejta e votës është guri themeltar i një sistemi demokratik.

Sikurse raportet ndërkombëtare e konstatojnë në vazhdimësi, Shqipëria ndodhet në një krizë përfaqësimi e cila po sjell pengesa në ngritjen dhe ripërtëritjen e institucioneve kushtetuese dhe të krijuara me ligj.

Prandaj me anë të kësaj projekt-rezolute kërkohet që institucionet shqiptare, bazuar në parimet demokratike, në institucionet demokratike dhe me një përfaqësim të ligjshëm të vijojë e përqëndruar në reformat e ndërmarra dhe t'i përfundojë ato në respektim të kuadrit kushtetues e ligjor në fuqi, duke bërë të mundur rezultate konkrete në zbatimin e përparësive të vendosura nga Komisioni European për hapjen e negociatave deri në anëtarësimin me të drejta të plota në Bashkimin European.

Projekt-rezoluta i drejtohet gjithashtu edhe shteteve anëtare të Bashkimit European në kuadër të *Summit*-it të ardhshëm të Këshillit European i cili do të mbahet me datat 17-18 tetor 2019, ku një ndër pikat e diskutimit në rendin e ditës do të jenë edhe vendimet për hapjen e negociatave me Republikën e Shqipërisë dhe me Republikën e Maqedonisë së Veirut.

Në kuadër të kësaj prespektive, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë angazhohet më tej për ecurinë e reformave dhe zbatimin e tij sipas funksioneve që Kushtetuta dhe ligjet në fuqi i kanë caktuar.

Pas propozimit të kësaj projekt-rezolute, Komisioni për Integrimin European e ka shqyrtuar atë në parim në datën 01.10.2019 ku në mbledhje është rënë dakort që të shqyrtohen më tej amendamentet e paraqitur.

Projekt-rezoluta ka kaluar nëpërmjet një procesi konsultimi të gjërë parlamentar si politik ashtu edhe administrativ. Konsultimi politik ka përfshirë grupet parlamentare, Komisionin e Politikës së Jashtme si dhe deputetë të ndryshëm që kanë paraqitur amendamentet e tyre. Këto amendamente janë përfshirë në dokumentin e miratuar nga Komisioni për Integrimin European në datën 02.10.2019.

Në përfundim, Komisioni me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm, mbështetur në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, miratoi projekt-rezolutën bashkëlidhur këtij raporti, të cilën ia paraqet për miratim Kuvendit.

RELATORE

SENIDA MESI

KRYETARE

RUDINA HAJDARI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKT – REZOLUTË
PËR MBËSHTETJEN E PROCESIT TË FILLIMIT TË BISEDIMEVE PËR
ANËTARËSIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN.

- Në zbatim të nenit 6 dhe nenit 75 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare”, nenit 14, pika (ë) e ligjit nr. 15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, nenit 106 dhe nenit 107 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe duke marrë në konsideratë rolin e Kuvendit, si organi më i lartë ligjberës dhe kontrollues;

Duke vlerësuar mbështetjen e vazhdueshme të Bashkimit European për ngritjen dhe forcimin e institucioneve demokratike të Republikës së Shqipërisë;

- Duke ritheksuar se objektivi kryesor strategjik i Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në Bashkimin Evropian, me mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme që Bashkimi European dhe shtetet e tij anëtare i kanë dhënë Shqipërisë në përmbushje të reformave për procesin e integritetit evropian;

- Duke konfirmuar vullnetin e palëkundur për të respektuar vlerat e sanksionuara në traktatet e Bashkimit Evropian dhe vendosmërinë për zhvillimin e një shoqërie demokratike, bazuar në sundimin e ligjit, respektin për të drejtat e njeriut dhe minoriteteve, si dhe në parimet e ekonomisë së tregut;

- Duke marrë në konsideratë rekomandimin e qartë të Komisionit European të datës 17.04.2018, rikonfirmuar në datën 29.05.2019, për fillimin e bisedimeve për anëtarësim të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European si dhe përfundimet e Këshillit të Bashkimit European, të mbështetura nga Këshilli European, të qershorit 2018, i cili përcakton fundin e vitit 2019 si periudhën e zyrtarizimit të këtyre bisedimeve;

- Duke vlerësuar punën përgatitore të nisur nga Komisioni European me institucionet shqiptare në lidhje me analizën e legjislacionit shqiptar kundrejt *acquis* të Bashkimit European të njohur si procesi “*screening*”;

- Duke rikonfirmuar angazhimet që burojnë nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë nr. 1621 datë 24.05.2018, “Për rekomandimin e Komisionit Evropian për hapjen e negociatave të anëtarësimit midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë”;

- Duke marrë në konsideratë faktin se dialogu politik konstruktiv, gjithëpërfshirja dhe transparencja, të mbështetura në parimet demokratike dhe institucionet kushtetuese janë thelbësore për progresin e qëndrueshëm të institucioneve të Shqipërisë në procesin e integritetit evropian;

- Duke shprehur angazhimin tonë për të vijuar reformat e ndërmarra në kuadër të procesit të integritetit evropian, duke patur parasysh përparimin e bërë nga Shqipëria në plotësimin e rekomandimeve kyçe të Komisionit Evropian, zbatimin e qëndrueshëm të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, dhe në veçanti përparësitë e vendosura nga Komisioni Evropian si kusht paraprak për çeljen e negociatave;

-Duke u bazuar në raportin e fundit të OSBE/ODIHR dhe duke konsideruar themelore zbatimin e rekomandimeve të raportit të mësipërm për reformën zgjedhore sipas parimeve demokratike dhe brenda kuadrit kushtetues dhe institucional;

- Duke theksuar rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të rolit të shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit, në procesin integruar të vendit, me qëllim forcimin e dialogut gjithëpërfshirës dhe rritjen e transparencës në procesin e integritetit evropian;

- Duke theksuar synimin për forcimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarive të organeve, nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron përgjegjësinë e tij në procesin e integritetit evropian;

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

1. Vlerëson Raportin e Komisionit Evropian të datës 29.05.2019 dhe rekomandimet e tij për reformat e mëtejshme në kuadër të procesit të integritetit evropian;
2. Vlerëson rolin e tij në drejtim të zhvillimit të dialogut gjithëpërfshirës, mbështetur në parimet demokratike, brenda kuadrit kushtetues dhe institucional mbi çështjet e integritetit evropian;
3. Inkurajon forcimin e mëtejshëm të rolit të tij në mbikqyrje të reformave integruese të vendit;
4. Thekson se angazhimi i qëndrueshëm institucional për përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe zbatimin e përfundimeve të Këshillit Evropian përbën përparësinë kryesore të punës së Kuvendit të Shqipërisë;

5. Mbështet fort reformën në Drejtësi dhe angazhohet të bashkëpunojë dhe të nxisë institucionet përgjegjëse, me qëllim ngritjen dhe funksionimin e Prokurorisë Speciale Kundër Korrupsionit (SPAK), Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) dhe plotësimin e vendeve të lira në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë si dhe zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm, brenda vitit 2019;
6. Kërkon nga organet ligjzbatuese, rezultate konkrete dhe të vazhdueshme në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, si dhe në respektim dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve;
7. Shpreh vullnetin e plotë për forcimin e frymës së mirëkuptimit ndërpartiak dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile në rrugën e thellimit të reformave të ndërmarra në kuadër të procesit të anëtarësimit;
8. Shpreh gatishmërinë e plotë për kryerjen e një reforme terësore dhe gjithëpërfshirëse zgjedhore brenda mandatit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën zgjedhore sipas parimeve demokratike dhe standarteve ndërkombëtare, në interes të qytetarëve shqiptarë;
9. Shpreh angazhimin e plotë dhe i kërkon Këshillit të Ministrave dhe institucioneve të pavarura zbatimin e përparësive të vendosura nga Komisioni Europian, me fokus sundimin e së drejtës dhe liritë e të drejtat themelore;
10. I kërkon Këshillit të Ministrave që të paraqesë brenda datës 31 Janar 2020 planin e punës, metodologjinë, planifikimin e burimeve njerëzore dhe financiare në mbështetje të procesit të bisedimeve për anëtarësimin në Bashkimin Europian;
11. Fton vendet anëtare të Bashkimit Europian që në përputhje me rekomandimet e Komisionit Europian të datës 17.04.2018, rikonfirmuar në datën 29.05.2019, si dhe përfundimet e Këshillit të Bashkimit Europian, të mbështetura nga Këshilli Europian, të qershorit 2018, të zyrtarizojnë hapjen e bisedimeve për anëtarësim me Republikën e Shqipërisë.

Miraturar në datën . . .2019

KRYETARI

Gramoz RUÇI